

RELACIONI TEKNIK

OBJEKTI: “NDËRTIM RRJETI KANALIZIMI I UJËRAVE TË NDOTURA LAGJJA NR. 7 RRUGA “PUNËTORËT E RILINDJES”, “ISUF MOLLA”, “AFËRDITA” DHE LAGJJA NR.10 RRUGA “LUFTËTARËT E LIRISË”, “HORIZONTI I KALTËR”, “AKROPOLI” DHE “POMPEU”, DURRËS”



NËNTOR 2018

RAPORTI TEKNIK

OBJEKTI : “NDËRTIM RRJETI KANALIZIMI I UJËRAVE TË NDOTURA LAGJJA NR. 7 RRUGA “PUNËTORËT E RILINDJES”, ”ISUF MOLLA”,“AFËRDITA ” DHE LAGJJA NR.10 RRUGA “LUFTËTARËT E LIRISË”,”HORIZONTI I KALTËR” “AKROPOLI” DHE ”POMPEU”, DURRËS”

1. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT.

1. Të Përgjithshme

Hartimi i projektit të objektit: Ndërtim rrjeti i ujërave të ndotura “Lagjja nr.7 rruga “Punëtorët e Rilindjes”, “Isuf Molla”, “Afërdita”, Lagjja nr.10 rruga “Luftëtarët e Lirisë”, “Horizonti i Kaltër” “Akropoli” dhe “Pompeu”, Bashkia Durrës” është bërë nga stafi i Degës Teknike sh.a Durrës bazuar në kërkesat e qytetarëve për ndërtim rrjeti kanalizimi, pasi në mungesë të këtij rrjeti oparohet me gropa septike.

Shkarkimi i ujërave të ndotura të linjave kryesore do të bëhet në kolektorin ekzistues.

2. Vendndodhja e objektit dhe gjendja ekzistuese e rrjetit të kanalizimeve

Zona ku do të kryhet investimi ndodhet në pjesën veriperëndimore të qytetit dhe përfshin lagjjen nr.7 rrugët “Punëtorë e Rilindjes”, “Isuf Molla” dhe “Afërdita”, si dhe lagjjen nr.10 rrugët “Luftëtarët e Lirisë”, “Horizonti i Kaltër”, “Akropoli” dhe “Pompeu”, e cila për shkak të ndryshimeve demografike karakterizohet nga një dendësim popullsie dhe një numër i konsiderueshëm ndërtime të reja.

Referuar pozicionimit gjeografik, zona ndodhet në pjesën kodrinore të qytetit dhe përbëhet kryesisht nga ndërtime informale një deri në disa katëshe, të cilat vuajnë nga mungesa e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, pasi si zonë relativisht e re nuk ka një rrjet të mirëfilltë kanalizimesh. Banorët e zonës e kanë zgjidhur këtë problem me anë të ndërtimit të gropave septike, të cilat të ndërtuara jashtë kushteve teknike shkaktojnë filtrime të ujërave të ndotura duke sjellë probleme dhe në infrastrukturën e zonës.

3. Gjendja ekzistuese e rrjetit të kanalizimeve

Nisur nga gjendja aktuale e infrastrukturës së zonës lind e domosdoshme shtrim linjash kanalizimi, që bëjnë të mundur sistemimin e ujërave të ndotura duke eliminuar ndërtimet jashtë kushteve teknike të gropave septike.

Për sistemimin e ujërave të ndotura në këtë zonë, dega teknike ka parashikuar ndërtim rrjeti të ri kanalizimi, ku tubacioni kryesor i kanalizimit do të realizohet me tubacion të brinjëzuar HDPE SN8 Ø 315 mm me gjatësi L= 515 m, ndërsa linjat sekondare me tubacion të brinjëzuar HDPE SN8 Ø 250 mm me gjatësi L= 875 m dhe tubacion HDPE SN8 Ø 200 mm me gjatësi L = 670 m. Projekti ka marrë në konsideratë ato objekte që nuk janë përfshirë në projektin e mëparshëm të kanalizimit duke sistemuar në këtë mënyrë të gjithë zonën me rrjet kanalizimi.

Sasia e ujit që shkarkohet nga kjo zonë është llogaritur për afro 800 banorë

Shkarkimi i linjës kryesore të kanalizimit tubacioni i brinjëzuar Ø HDPE SN8 Ø 315 mm do të bëhet në kolektorin ekzistues përkatësisht tubacion Ø 1500 mm b/arme në rrugën: "Isuf Molla" dhe në këtë linjë është parashikuar ndërtimi i 21 copë puseta shkarkimi, duke zbatuar kriterin e vendndosjes së tyre në zonat ku ka kryqëzime me rrugët dytësore të zonës. Gjithashtu për këtë linjë është parashikuar dhe ndërtimi i pusetës beton/arme 1.5 x 1.5 x 2.5 m mbi kolektorin ekzistues ku do të bëhet shkarkimi i linjës kryesore të re.

Pusetat e shkarkimit janë parashikuar beton/arme, me përmasa 80 x 80 cm dhe h= 100 ÷ 150 cm në varësi të diametrit të tubacionit, me kapak gize dhe në çdo pusetë është llogaritur dalja e tubacioneve të shkarkimit të UN të objekteve të zonës .

Linja sekondare tubacion HDPE SN8 Ø 250 mm parashikuar të shtrihet në rrugën "Pompeu", do të shkarkojë në linjën ekzistuese K-12 tubacion Ø 400 mm betoni të rrugës "Ibrahim Buzhiqi", pasi kjo pjesë e zonës për shkak të kushteve topografike nuk mund të shkarkojë në kolektorin ekzistues Ø 1500 mm beton/arme të rrugës "Isuf Molla".

II. OBJEKTIVI.

Qellimi i këtij projekti është sistemimi i ujërave të ndotura për zonën e shqyrtuar më sipër nëpërmjet ndërtimit të një linje efikase kanalizimi që ti shërbejë të sotmes dhe të ardhmes duke përmirësuar në mënyrë të dukshme infrastrukturën e zonës.

III. QËLLIMI I PROJEKTIT.

Ndërtimi i këtij rrjeti kanalizimi, konsiston në eliminimin e ndërtimit jashtë kushteve teknike të gropave septike, si dhe në sigurimin e një mjedisi të pastër pa praninë e ujërave të ndotura në sipërfaqe.

Projekti përfshin:

- Ndërtim linje kryesore kanalizimi me tubacion hdpe Ø 315 mm.
- Ndërtim linje sekondare kanalizimi me tubacion hdpe Ø 250 mm.
- Ndërtim linje sekondare kanalizimi me tubacion hdpe Ø 200 mm.

- Ndërtim puseta shkarkimi b/a 0.8x0.8x1.0 m në linjën kryesore.
- Ndërtim puseta shkarkimi b/a 0.8x0.8x1.0 m në linjat sekondare.
- Ndërtim pusete kontrolli b/a 1.5x1.5x2.5m mbi tubacionin ekzistues Ø1 500mm b/arme.

IV. VOLUMET E PUNIMEVE.

Ndërtim i rrjetit të kanalizimit të UN, objekt i detyrës të projektimit, përfshin punime shtresa betoni dhe ndërtimin e pusetave të shkarkimit b/a 0.8x0.8x1.0m dhe 0.8x0.8x1.5 m si dhe pusetë kontrolli b/a 1.5x1.5x2.5 m

Volumet kryesore të punimeve janë:

1. Prerje shtresa betoni	m ²	172
2. Gërmim dheu me makineri	m ³	1421
3. Transport dheu me makineri	m ³	1421
4. Shtresë rëre	m ³	596
5. Nënshtrësë zhavorri	m ³	689
6. Shtresë betoni C 16/20	m ³	172
7. Shtresë çakëlli mbeturinë t=10cm	m ²	95
8. Pusetë shkarkimi b/a 0.8x0.8x1.0 m	cope	67
9. Pusetë shkarkimi b/a 0.8x0.8x1.5 m	cope	21
10. Pusetë kontrolli b/a 1.5x1.5x2.5 m	cope	1

V. KONKLUZIONE.

Në përfundim të projektit për zonën në studim me objekt “Ndërtim rrjeti kanalizimi UN lagjjet nr.7 dhe nr.10 “konkludojmë si më poshtë:

Projekti do të realizohet në një fazë.

Preventivat e zbatimit janë vlerësuar sipas VKM. Nr.629 date 15.07.2015.

Në preventiv është përfshirë Fondi rezerve 5% dhe dhe 20% T.V.SH

Analizat e çmimeve sipas normativave të tregut.

Projektues

Ing. Hidro.Gerald Dautaj
 Ing. Hidro. Lorenc Facja
 Ing. Hidro.Bledar Metalla
 Ing. Hidro. Qamile Qehajaj
 Ing. Ndertimi.Artor Koçilja

PROJEKT ZBATIMI

OBJEKTI: “NDËRTIM RRJETI KANALIZIMI I UJËRAVE TË NDOTURA LAGJJA NR. 7 RRUGA “PUNËTORËT E RILINDJES”, “ISUF MOLLA”, “AFËRDITA” DHE LAGJJA NR.10 RRUGA “LUFTËTARËT E LIRISË”, “HORIZONTI I KALTËR” “AKROPOLI” DHE “POMPEU”, DURRËS”



- RELACIONI TEKNIK
- PREVENTIVI I OBJEKTIT
- ANALIZAT TEKNIKE TË ÇMIMEVE
- SPECIFIKIMET TEKNIKE
- FLETË PROJEKTI

PREVENTIV

OBJEKTI: “NDËRTIM RRJETI KANALIZIMI I UJËRAVE TË NDOTURA LAGJJA NR. 7 RRUGA “PUNËTORËT E RILINDJES”, “ISUF MOLLA”, “AFËRDITA” DHE LAGJJA NR.10 RRUGA “LUFTËTARËT E LIRISË”, “HORIZONTI I KALTËR”, “AKROPOLI” DHE “POMPEU”, DURRËS”



ANALIZA TEKNIKE

OBJEKTI: “NDËRTIM RRJETI KANALIZIMI I UJËRAVE TË NDOTURA LAGJJA NR. 7 RRUGA “PUNËTORËT E RILINDJES”, “ISUF MOLLA”, “AFËRDITA” DHE LAGJJA NR.10 RRUGA “LUFTËTARËT E LIRISË”, “HORIZONTI I KALTËR”, “AKROPOLI” DHE “POMPEU”, DËRRËS”



NËNTOR 2018